

Programi i studimit: Mësimdhënës i AAP, Niveli 7 i KKK

Niveli i studimeve: Master

Numri i kredive: 120 ECTS

Përmbajtja

QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	3
Titulli profesional - Mësimdhënës i AAP, niveli 7.....	3
Përshkrimi i punës.....	3
Detyrat të punës	4
Mjedisi i punës dhe aspekte të veçanta të punës.....	4
Mjetet e punës.....	5
Karakteristikat personale të nevojshme për këtë punë: aftësitë dhe tiparet e personalitetit.....	5
Përgatitja profesionale.....	5
Arsimi profesional	5
Supozimet për mësimdhënësit e AAP niveli 7 i KKK	5
Kushtet hyrëse;	8
Kompetencat bazë të kualifikimit	8
PASQYRA E PROGRAMIT: për mësimdhënësit e AAP niveli 7 i KKK	10
PËRSHKRIMI PËR SECILIN MODUL.....	11

QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i kualifikimit për **Mësimdhënës të AAP**, niveli i 7 i KKK, bazuar në Standardin e Profesionit është aftësimi i mësimdhënësve për shkollat e mesme të larta profesionale në Kosovë, në sistemin e AAP postsekondar jo terciar dhe në IAAP. Ky kualifikim iu dedikohet të gjithë kandidatëve që kanë përfunduar cilindo nga fakultetet dhe kanë arritur të gradën bachelor dhe që përcaktohen dhe duan ta zhvillojnë karrierën e tyre për profesionin e mësimdhënësit në shkollat e mesme të larta profesionale dhe në IAAP.

Programet e AAP duhet të përmbushin bazat dhe kërkesat tjera të arsimit profesional, si dhe të teknologjisë arsimore. Përvoja paraprake e punës në industri apo sektorët e biznesit është një përparësi e madhe për ata që dëshirojnë të vazhdojnë karrierën e tyre në AAP, megjithatë për të vazhduar studimet master të AAP në nivelin 7 të KKK, kusht i domosdoshëm është që kandidati të ketë të kryer studimet bachelor me të paktën 180 ECTS në fushën përkatëse profesionale ose të ngjashme.

Mësimdhënësit në arsimin profesional punojnë në shkollat e mesme profesionale, në sistemin e AAP postsekondar jo terciar dhe IAAP dhe detyrë e tyre është të mësojnë nxënësit/kandidatët shkathtësitë në profesionin e tyre të veçantë, përfshirë edhe shkathtësitë teknike. Pozita si mësimdhënës i AAP kërkon përvojë ose trajnim në fushat që ata japin mësim. Shpesh herë para mësimdhënësve të AAP shtrohen kërkesa për të arritur një diplomë master të AAP bazuar në standardin e profesionit si dhe zhvillimim i vazhdueshëm profesional. Atyre ju duhet të demonstrojnë kompetencë për të ushtruar profesionin në fushën profesionale.

Titulli profesional - Mësimdhënës i AAP, niveli 7

Përshkrimi i punës

Mësimdhënësi i AAP është **profesionist**, i cili përkrahë procesin e të mësuarit dhe përparimin e nxënësve, mundësitë dhe nevojat, duke i marrë parasysh objektivat e vendosura në Kornizën Kombëtare e Kurrikulës dhe Kornizën Bërthamë të Kurrikulës së AAP dhe ti zhvillojë shkathtësitë e veta profesionale.

Për kualifikimin master të AAP niveli i 7 i KKK, programi i studimeve është i përgatitur që mësimdhënësve potencial të AAP t’ju ndihmoj në zhvillimin e kompetencave profesionale që do tu mundësonin nxënësve të tyre për ti zhvilluar shkathtësitë për punësim, zhvillim, por edhe përparimin në karrierë. Fusha tjera me rëndësi përfshijnë përcjellja e trendeve industriale në fushën e arsimit, politikat arsimore dhe të punësimit, si dhe legjislacionin që ka të bëjë me kualifikimin e fuqisë punëtore.

Sipas kërkesave të Standardit të Profesionit për mësime të nivelit 7 të KKK, kualifikimi për mësime të AAP duhet të përmbajë modulet për; zhvillim të kurrikulave të AAP, metodave të mësimit dhe hulumtimit, principet dhe trendet e AAP, përfshirë pjesën e statistikës dhe matjen e rezultateve, shfrytëzimin optimal të resurseve në dispozicion për zgjidhje më të mira, liderhipit etj, me kohëzgjatje në shumicën e rasteve deri në dy vjet studimi apo 120 ECTS.

Mësuesi i AAP në nivelin e 7 e planifikon procesin e mësimit në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me kolegët, jep mësim dhe zhvillon një ambient miqësor dhe përkrahës për nxënësit. Ai/ajo reflekton për aktivitetet e tija me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Nëse është e nevojshme konsultohet me këshilltarët e karrierës ose mësuesit mentor për punën dhe aktivitetin e tij/sajë dhe konsultohet me nxënësit dhe prindërit.

Mësuesi i AAP në nivelin e 7 të KKK, merr pjesë në zhvillimin dhe aktivitetet kreative të një IAAP, si pjesë e stafit, bashkëpunon me kolegët, përkrahë specialistët e fushës, prindërit dhe nxënësit.

Ai / ajo analizon nevojat për trajnim, përcakton qëllimet dhe objektivat dhe përgatitjen e kurrikulave; mbikëqyrë ekuipazhin dhe kërkon zgjidhje për problemet të cilat janë bërë të dukshme në rrjedhën e punës.

Detyrat të punës

1. Përgatitja e procesit mësimor për AAP (aktivitetet e mësimit dhe mësimit)
2. Zhvillimi i ambientit mësimor
3. Përkrahja e mësimit dhe zhvillimit
4. Reflektimi dhe vet-zhvillimi profesional
5. Konsultimi/Këshillimi
6. Aktivitetet kreative, zhvilluese dhe hulumtuese

Mjedisi i punës dhe aspekte të veçanta të punës

Orari i punës dhe pushimi i mësuesve të AAP është i rregulluar me kontratën e punës. Kushtet e punës mund të rregullohen në mënyrë plotëse me anë të masave organizative dhe rregullative të IAAP dhe dokumenteve tjera normative që janë në fuqi. Puna si mësues i AAP është e ndryshme dhe sfiduese, kërkon shkathtësi të mira komunikuese dhe menaxhim të mirë të stresit. Për profesionin e mësuesit të AAP janë të rëndësishme shkathtësitë për ruajtje të shëndetit mendor dhe fizik, përfshirë edhe zërin.

Mjetet e punës

Veglat kryesore e mësimdhënësit janë materialet mësimore, pajisjet, veglat dhe makinat e laboratorëve dhe punëtorive të IAAP, përfshirë edhe dërrasën e zeze, veglat e TIK, programet dhe veglat speciale dhe materialet sipas fushës profesionale apo profesionit.

Karakteristikat personale të nevojshme për këtë punë: aftësitë dhe tiparet e personalitetit

Tipare të rëndësishme të mësimdhënësit të AAP janë vet-menaxhimi, bashkëpunimi, iniciativa, përgjegjësia, vetëbesimi, kreativiteti, toleranca, empatia dhe integriteti dhe qëndrimi pozitiv.

Përgatitja profesionale

Përgatitja profesionale e mësimdhënësit të AAP është e rregulluar me Ligjin e Arsimit Parauniversitar dhe Ligjin e AAP, dhe legjislacionin sekondar.

Arsimi profesional

Mësimdhënës i AAP në nivelin e 7, në shumicën e rasteve është mësimdhënësi i cili ka një diplomë në nivel masteri ose një shkallë që është ekuivalente me të. Përgatitja profesionale e tij/ sajë mund të arrihet në studimet pasuniversitare dhe /ose me ndonjë gradë profesionale për mësimdhënës pas kryerjes së studimeve themelore të gradës bachelor nga niveli i 6 i KKK.

Supozimet për mësimdhënësit e AAP niveli 7 i KKK

Kualifikimi profesional, mësimdhënës i AAP në nivelin 7 të KKK është një kualifikim profesional akademik. Profesionit përfshinë njohuritë e veçanta dhe të përgjithshme për mësimdhënie, duke kombinuar perspektivën kritike të hulumtimit me nevojën për zgjidhjen e problemeve, njohuritë për module profesionale teorike dhe praktike dhe metodologjinë e mësimdhënies për aktivitete të përditshme shkollore.

Programi për mësimdhënësin e AAP në nivelin 7 të KKK është i bazuar në tri kompetenca kyçe:

- kompetencat e përmbajtjes teorike dhe praktike mësimore,
- kompetencat e metodologjisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies,
- kompetencat e lidërshiptit.

Kompetenca mbi përmbajtjen e vë theksin mbi njohuritë e mësimin, duke konsideruar faktin që për mësimdhënie kandidatit i nevojiten njohuri të avancuara në fushën profesionale.

Kompetenca e metodologjisë paraqet nevojën për të marrë në konsideratë kapacitetin e secilit kandidat, e gjithashtu edhe sfidat për secilin modul. Kompetenca e lidershit, përmban shkathtësitë për të krijuar një mjedis mësimor sfidues dhe të përshtatshëm. Kulifikimi për mësimdhënës duhet gjithashtu duhet të përgatis studentët për detyrën e tyre në vlerësimin e aktiviteteve dhe të arriturat mësimore të nxënësve të AAP, e gjithashtu edhe të arriturat personale dhe të tjerëve.

Të diplomuarit me së paku gradën bachelor në fusha të ndryshme profesionale, mund të shtojnë ose ndryshojnë kualifikimin e tyre për mësimdhënës të AAP në nivelin 7 të KKK. Ky kualifikim është gjithashtu i përshtatshëm për të diplomuarit në fushat teknike dhe profesione tjera dhe që dëshirojnë ti rrisin mundësitë për tu punësuar në cilësinë e mësimdhënësit në IAAP. Gjithashtu, studimet në këtë nivel mund ti ndjekin edhe mësimdhënësit që janë të punësuar në IAAP dhe dëshirojnë ti freskojnë, njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat, qoftë edhe në module të veçanta.

Kushtet e përgjithshëm për këtë nivel janë studimet bachelor të përfunduara në ndonjërin nga fushet profesionale, ndërsa studimet për mësimdhënësit e AAP niveli 7 i KKK janë të organizuara në formë modulare ku secili modul i ka të paktën nga 30 orë mësimore dhe nëse organizohen në bllok procesi zgjatë nga 4-5 ditë me nga 6-8 orë. Për këtë nivel janë të parapara edhe module të studimeve të përgjithshme e cila ndryshon varësisht nga fusha profesionale, ndërsa pjesa tjetër janë lëndë të teorisë dhe praktikës profesionale.

Përparësi e studimeve të organizuara në formë modulare është sepse mësimdhënësit e AAP do të pajisen me dëshmi ose certifikatë për secilin modul të kaluar me sukses edhe për rastet nëse nuk arrijnë që ti përfundojnë në tërësi studimet master. Këto certifikata do tu shërbejnë mësimdhënësve që të tregojnë se kanë arritur kualifikime të larta në lëmi të veçanta profesionale dhe do të mund të punësohen nga IAAP.

Studimet e organizuara në formë modulare mund të jenë 1 deri 4 semestra ose prej 30 deri 120ECTS, në vartësi nga kualifikimi paraprak të studentëve apo nevoja për të përmbushur nivelin minimal të ECTS të kërkuar sipas kornizës ligjore në fuqi për mësimdhënës të IAAP. Punimi i diplomës do të ketë 30 kredi, ndërsa studenti duhet ta përfundoj si projekt final në kompani. Nëse nuk ka vend në kompani atëherë punimi i masterit mund të punohet si projekt përfundimtar nga studenti ose ekipi i studentëve (1 deri 4 vetë në ekip), në laboratorët e universitetit ose të IAAP. Përparësi është që punimi i temës së masterit të bëhet në kompani, sepse i jepet mundësia të palëve të kenë raporte bashkëpunimi në të ardhmen. Kreditë do të kalkuloohen si për pjesën teorike dhe pune praktike (puna laboratorike). Gjithashtu sipas këtij standardi të profesionit në përbërje të kualifikimit për mësimdhënës në nivelin e 7 të KKK mund ti shtohet edhe Moduli “Kapituj të zgjedhur”, që mund të freskohet dhe ndryshohet për secilin semestër sipas kërkesave të IAAP, MASHT apo tregut të punës, kjo nënkupton që disa prej

lëndëve mund të largohen apo shtohen. Mënyra më efikase për transferimin e të arriturave dhe “know how”, është që për ndonjërin nga modulet apo modulën “kapituj të zgjedhur”, është që të punësohen mësimdhënës apo ekspert të kualifikuar nga kompanitë në cilësinë e ligjëruesve.

Fakulteti ose fakultetet që ofrojnë kualifikimin në nivelin 7 të KKK, për fushat teknike supozohet që i kanë të pajisura laboratorët për fushat kryesore si: Fizikës, Mekanikës, Inxhinierinë Elektrike, por edhe pajisje të rëndësishme me njësitë për trajnime për teorinë profesionale si; studimeve kompjuterike, sensorikë, teknologjinë e aktuatorëve, sisteme mekatronike, automatizim, teknologji e ngasjes, elektronikë etj.

Për mësimin e teorisë profesionale, kandidatët për kualifikim 7 të KKK duhet ta realizojnë përmes materialeve mësimore, udhëzuesve, skemave dhe formave tjera nga mësimdhënës të përgatitur, përfshirë edhe platformat e-learning.

Pajisjet e përdorura për pjesën praktike për të përgatitur mësimdhënësit e AAP për nivelin 7 të KKK, duhet ti përmbushin kërkesat e industrisë. Prandaj, sidomos studentëve në semestrin e fundit u kërkohet që të jenë në gjendje të punojnë me pajisje të cilat më vonë do ti përdorin gjatë punës së tyre me kandidatë në IAAP, e sidomos ajo çka është me rëndësi që në mënyrë të pavarur të operojnë me pajisje.

Kërkesat për Fakultetin ose njësitë akademike që ofrojnë nivelin e 7 të kualifikimit për mësimdhënës të AAP kanë të bëjnë me plotësimin e disa kushteve materiale;

- Kualifikimi i zhvilluar në formë modulare, bazuar në standardin e profesionit,
- Pajisjet e duhura dhe atyre eksperimentale sipas fushës së caktuar,
- Materialet mësimore (libra, dispensa, udhëzues, platforma të e-learning etj),
- Zgjidhje “Train dhe trainers”.

Nëse bëhet fjalë për kualifikim të nivelit 7 të KKK në fushat teknike atëherë, varësisht nga specializmi janë të nevojshëm laboratorët në vijim:

- Metalpërpunues dhe bazave të elektroteknikës,
- Elektronikës,
- Automatizim industrial (me PLC) dhe teknologji e mirëmbajtjes,
- E-learning (multimedial),
- CNC teknologji,
- CIM/FMS (Computer Integrated Manufacturing dhe Flexible Manufacturing Systems).

Pajisjet duhet të jenë të orientuara kah praktika dhe në to duhet të mund të bëhen shumë eksperimente që janë shumë afër me aplikacionet industriale dhe kërkesave eventuale të ndërmarrjeve. Natyrisht se kërkesat e sigurisë duhet të trajtohen në rendin e parë.

Numri i eksperimenteve varet nga numri i nxënësve. Supozohet se numri i studentëve është 32 për grup, ndërsa në një grup duhet të marrin pjesë maksimalisht 4 studentë.

Kushtet hyrëse; Fakultetin në fushën përkatëse ose të afërt në nivelin bachelor me të paktën 180ECTS për studimet dy vjeçare ose 240 kredi për studimet 1 vjeçare. Provimi pranues duhet të organizohet për lëndët bazike psh. në fushat teknike: Matematikë, një lëndë profesionale dhe test logjik, në gjuhën Angleze ose Gjermane. Mësimdhënësit me përvojë pune mbi 3 vjeçare në IAAP dhe fond të trajnimeve profesionale por edhe didaktikë profesionale dhe metodologji të mësimdhënies, duhet të intervistohen dhe tu njihet një pjesë e kualifikimit në vartësi të kredive të akumuluar.

Kompetencat bazë të kualifikimit

Bazuar në standardin e profesionit nga mësimdhënësit e AAP niveli i 7 i KKK kërkohet të demonstrojnë kompetencë profesionale; njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të nevojshme për kryerjen e suksesshme të punës siç janë në:

- 1) Përgatitjen, vlerësimin dhe zhvillimin e kurrikulave dhe programeve të AAP në përputhje me kërkesat e tregut të punës;
- 2) Vlerësimin e kompetencës së individëve, duke përfshirë vetë-vlerësimin dhe konformitetin e vlerësimit me rastin e arritjes së këtij kualifikimi;
- 3) Përshkrimin dhe hyrjen në profesion;
- 4) Planifikimin e karrierës dhe krijimin e bazës për të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- 5) Përcaktimin e nevojave për trajnim dhe planifikimin e trajnimeve;
- 6) Përgatitjen e përshkrimit të detyrave të punës dhe rekrutimin e punonjësve;
- 7) Krahasimin e profesioneve dhe kualifikimeve.

Mësimdhënësi i AAP-së në nivelin 7 të KKK duhet të:

1. Drejtoj/udhëheqë procesin mësimor për modulin dhe fushat, ka njohuri për përditësimet në modulin ose fushën, bazat e hulumtimit dhe praktikat më të mira si dhe kërkesat që kanë të bëjnë nga korniza e kurrikulës;
2. Përdor gjuhën e duhur të mësimdhënies me gojë dhe në të shkruar dhe shprehet në mënyrë të qartë; e njeh gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi në nivel të shkëlqyeshëm dhe një gjuhë të huaj të paktën në nivel të komunikimit;

3. Vëren, vëzhgon dhe ja pranon të arriturat dhe frymëzon nxënësit, prindërit dhe kolegët, vlerëson edhe përparimet e vogla;
- 4. Ka njohuri për metodologjinë e mësimdhënies në fushën apo modulën specifike profesionale, përfshirë praktikën profesionale si dhe njohuri mbi procesin e mësimdhënies dhe punës me të rritur;**
- 5. Ka njohuri për teorinë e shkencës dhe metodat hulumtuese kualitative dhe kuantitative, sikurse mbi lidhjen ndërmjet bazave shkencore dhe përvojë të dëshmuar dhe relevancës së sajë për sa i përket praktikës profesionale;**
- 6. Ka njohuri dhe i kupton marrëdhëniet sociale, menaxhimin e konflikteve dhe lidhshirë;**
7. Tregon respekt dhe kujdes në komunikim; vendos prioritetet për njerëzit, punon në mënyrë efektive secilin nxënës dhe në grup; pranon dallimet e njerëzve dhe i merr ato parasysh në bashkëpunim, vlerëson bashkëpunimin si vlerë të shtuar;
8. Krijon një mjedis pozitiv të komunikimit dhe sillet në përputhje me praktikën e mira të komunikimit; komunikon me sukses me njerëz nga nivele të ndryshme dhe grupe të synuara, krijon rrjetet e komunikimit të nevojshme për bashkëpunim; zhvillon aftësitë e komunikimit të nxënësve; analizon dhe zhvillon aftësitë e komunikimit, jep kritika konstruktive dhe është i hapur për të;
9. Niset nga etika profesionale e një mësimdhënësi në punën e tij / saj; mbështet njohjen më të gjerë dhe vlerat e etikës profesionale dhe profesionin e një mësimdhënësi në shoqëri përmes aktiviteteve të veta; zhvillon dhe ndjek vlerat dhe standardet e shoqërisë në mjedise të ndryshme; zhvillon vlerat e nxënësit me shembullin e vet;
10. Vepron si një qytetar i ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm, mbështet zhvillimin demokratik të shoqërisë;
11. Identifikon anët e tij / saj të forta dhe të dobëta dhe i merr ato parasysh në punën e tij / saj; punon sipas aftësive të veta;
12. Përdor gjuhën dhe metodat matematikore në detyrat e tij / saj të punës (p.sh. për analizën dhe interpretimin e të dhënave, arritjen e përfundimeve, gjeneralizime);
13. Orientohet në arritjen e rezultateve dhe objektivave të punës personale; kërkon mundësitë për vetë-zhvillim dhe avancim në karrierë; ofron dhe realizon ide të reja duke marrë parasysh njohuritë e modulit apo fushës, bazat kërkimore dhe praktikën më të mirë; vëren problemet dhe mundësitë; reagon me fleksibilitet ndaj ndryshimeve dhe supozon rreziqet e arsyeshme;
- 14. Përdorë dhe ka shkathtësi në përdorimin e veglave digjitale në mënyrë të sigurtë në proceset mësimore dhe ka aftësi të marrë në konsideratë rolin e medieve të ndryshme dhe mjediseve të ndryshme digjitale në këto procese;**

15. Përdor vegla të përshtatshme të TIK, zhvillon mjedis të përshtatshëm të mësimit dhe kryerjen e aktiviteteve mësimore; përdor mjedise dhe metoda të përshtatshme për mësimdhënie dhe e-mësim; përdorë mjete bashkëkohore të komunikimit me TIK;
16. Vlerëson dhe zhvillon kompetencat veta të teknologjisë për ta përdorë në procesin mësimor.
17. Interpreton legjislacionin që ka të bëjë me fushën e arsimit;
18. Përshkruan principet në të cilat është ndërtuar shoqëria Kosovare;
19. Përshkruan mënyrën institucionale në të cilën është ndërtuar sistemi i AAP.

PASQYRA E PROGRAMIT: për mësimdhënësit e AAP niveli 7 i KKK

Viti i parë

Semestri i parë

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Psikologji e edukimit	O	2+2	6
2.	Teoria e mësimdhënies dhe mësimnxënies në AAP	O	2+2	6
3.	Metodat e hulumtimit në AAP	O	2+2	6
4.	Zhvillimi i kurrikulave në AAP	O	2+2	6
5.	Vlerësimi në AAP	O	2+2	6

Semestri i dytë

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Praktika pedagogjike (Metodat për mësimdhënie në AAP) I	O		12
2.	Strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies në AAP	O	2+2	6
3.	Programimi linear për planifikimin e AAP	O	2+2	6
4.	Politikat arsimore dhe legjislacioni	Z	2+2	6
5.	Kulturë e komunikimit dhe shkathtësitë komunikuese	Z	2+2	6
6.	Kapituj të zgjedhur nga problemet speciale në AAP	Z	2+2	6

Semestri i tretë

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Praktika pedagogjike (Metodat për mësimdhënie në AAP) II	O		9
2.	Edukimi për karrierë dhe mësimi gjatë gjithë jetës	O	2+2	6
3.	Menaxhimi i cilësisë në IAAP	O	2+2	5
4.	Edukimi inkluziv	O	2+2	5
5.	Arsimi i të rriturve	Z	2+2	5
6.	Teknologjitë e reja dhe mësimi në distancë	Z	2+2	5
7.	Zhvillimi profesional	Z	2+2	5
8.	Kapituj të zgjedhur	Z	2+2	5

Semestri i katërt

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Teza e masterit	O		30

PËRSHKRIMI PËR SECILIN MODUL

Nr	Përshkrimi i moduleve
1.	<p>Psikologji e edukimit (O), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Moduli trajton çështjet praktike dhe ato teorike në mësim dhe në të nxënë. Në këtë modul studentët përqendrohen në sjelljen njerëzore me përqendrim në zhvillim dhe të mësuarit, si rezultat i ndikimeve të brendshme dhe të jashtme të individit. Moduli përmban qasjet më të reja nga fusha e psikologjisë së edukimit për mësimdhënie efektive, si dhe trajton ndihmesën e përmbajtjeve të psikologjisë kognitive për të nxënit si proces intelektual. Po ashtu në modul trajtohen edhe aspektet intrinzike dhe ekstrinzike për motivimin e subjekteve për të nxënë të suksesshëm. Si edukim ka të bëjë me aplikimin e njohurive në proceset ku të mësuarit ndodh (shkolla dhe mjedise të tjera). Psikologjia e edukimit sqaron zhvillimet kognitive, gjuhësore, personale, sociale dhe morale, të cilat janë relevante për të kuptuar sjelljen e individëve, dallimet në mes të individëve.</p>
2.	<p>Teoria e mësimdhënies dhe mësimnxënies (O), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Ky modul është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë – të nxënit dhe pjesa e dytë – mësimdhënia. Moduli ofrohet për të promovuar filozofinë dhe strategjinë bashkëkohore të të nxënit dhe mësimdhënies. Përmes këtij Moduli ofrohen njohuri e shkathtësi themelore përkritazi me të nxënit, teoritë e të nxënit, stilet e të nxënit, konceptet rreth mësimdhënies, strategjive ndërvepruese të mësimdhënies, format e punës mësimore, planifikimi i punës mësimore, etj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teoritë e të nxënit dhe të mësimdhënies dhe të zbatojnë strategji ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat promovojnë të menduarit kritik dhe kreativ. Gjithashtu, studentët do të analizojnë plane të punës mësimore mbi bazën bashkëkohore të mësimdhënies dhe analizës së bërë në praktikën pedagogjike të shkollës kosovare.</p> <p>Studentët do të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. thellojnë njohuritë e tyre teorike dhe metodologjike për arsimin profesional dhe trajnimit në IAAP, dhe të jenë në gjendje për të interpretuar, aplikuar dhe reflektuar mbi aplikuar njohuritë komplekse të orientuar kah teoria dhe praktika, 2. Të jetë në gjendje për të përcaktuar, zbatuar dhe të reflektuar kërkesën për profesionalizmin dhe zhvillimin e kompetencave trajnimit për stafin mësimdhënës, 3. Zhvillimi i një vetëdije sistematike dhe metodike për problemet dhe fushat e veprimit në arsimin profesional dhe në IAAP dhe ndërmarrje, 4. Të jetë në gjendje për të reflektuar dhe integruar njohuritë që kanë të bëjnë me qasjet teorike dhe praktike ndaj metodave dhe didaktikës, duke analizuar kompleksitetin e tyre dhe për ti zbatojë ato në një mënyrë të përshtatshme për situatën, 5. Të jetë në gjendje për të analizuar dhe reflektuar mbi situata të ndryshme mësimore dhe për të mbështetur procesin e të mësuarit në mënyrë vëmendshme, reflektive dhe këshilluese, 6. të fitojnë aftësi bazike profesionale për planifikim didaktik, zhvilloj planet për lloje të ndryshme të ngjarjeve dhe të përdorin një gamë të gjerë të metodave për organizimin e procesve të mësimdhënies dhe të nxënit, hulumtimeve bazike dhe evolutive, 7. fitojnë aftësitë hulumtuese në mënyrë që të gjenerojnë njohuritë dhe të lidhin teorinë me praktikën.

3.	<p>Metodat e hulumtimit në arsim (O), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Moduli shqyrton aspektet e përgjithshme teorike dhe metodologjike të të kuptuarit dhe realizimit të një projekti hulumtues në fushën e arsimit. Moduli në njërën anë adreson qasjet dhe orientimet që duhet të zgjedhë hulumtuesi (ontologjia dhe epistemologjia), module në anën tjetër adreson aspektet teorike dhe praktike, si: definimi dhe formulimi i problemeve hulumtuese; formulimi i pyetjeve hulumtuese dhe i hipotezave; hartimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave; analiza dhe interpretimi i të dhënave (duke përfshirë përdorimin e programeve të ndryshme softuerike për analizën e të dhënave); raportimi i hulumtimeve. Moduli adreson edhe aspektet të ndryshme të hulumtimeve kualitative dhe kuantitative dhe shtjellon modele të ndryshme të hulumtimeve, si: studime rasti, hulumtime përshkruese, hulumtime etnografike, hulumtime vepruese, hulumtime vlerësuese etj. Në veçanti Moduli adreson modalitetet e analizës të dhënave sasore përmes përdorimit të programit SPSS si dhe analizën e të dhënave kualitative.</p> <p>Qëllimi i këtij moduli është që studentët të mësojnë të përdorin veglat e hulumtimit dhe të kuptojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre relevante profesionale bazuar në hulumtimet që kanë për objekt praktikat e caktuara dhe që të jenë në gjendje të organizojnë procesin mësimor në mënyrë të pavarur. Pas kompletimit të këtij moduli studentët duhet të jenë në gjendje të: kompletojnë, dokumentojnë dhe ta shqyrtojnë në mënyrë kritike projektet arsimore metodologjike dhe zhvillimore.</p> <p>Studentët zhvillojnë njohuri të metodave hulumtuese dhe teorinë e shkencës:</p> <ul style="list-style-type: none"> -planifikimin, kryerjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e një projekti të pavarur zhvillimor nën mbikëqyrje, - identifikimin, formulimin përfshirë edhe kufizimet për një çështje metodologjike specifike të mësimdhënies, -zgjedhjen dhe aplikimin e një metode përkatëse të vlerësimit, -kërkimin, vlerësimin dhe studimin e kërkimit në fushën e caktuar, -analizën kritike dhe hartimin e materialit empirik, -duke qenë i vetëdijshëm për kufizimet e parimeve ligjore dhe etike dhe përdorimin e llojeve të ndryshme të metodave dhe materialeve, -paraqitjes dhe diskutimin e projekteve zhvillimore të veta dhe të tjerëve.
4.	<p>Zhvillimi i kurrikulave në AAP (O), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të marrin vendime për planifikimin e kurrikulës, identifikuar dhe zgjedhur përmbajtjen e përshtatshme kurrikulare sipas fushës profesionale, si dhe të realizoj procedurat e kërkuara për të zbatuar dhe vlerësuar kurrikulën e AAP.</p> <p>Moduli trajton aspektet e zhvillimit historik të kurrikulës, zhvillimet që ndikojnë në formësimin e kurrikulës, si dhe ndikimin e kurrikulës në vlerat shoqërore, ekonomike dhe politike. Çështjet e tjera që adreson ku modul janë orientimet dhe parimet bazë në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës. Për më shumë, Moduli adreson çështjet specifike të hartimit të kurrikulave në fushën e arsimit profesional, duke ekspozuar studentët ndaj kurrikulave aktuale në fushën e AAP-së dhe analizën e tyre krahas filozofive dhe parimeve të zhvillimit dhe funksionimit të kurrikulave, si dhe duke bërë lidhjen me të kuptuarit e tregut të punës.</p> <p>Pas përfundimit të këtij moduli studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Definojnë kurrikulën, - Bëjnë dallimin ndërmjet terminologjisë: kurrikulë, udhëzime, kualifikim, kurs

	<p>dhe program,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikojnë elementet e nevojshme për hartimin e kurrikulave, - Merr vendime për sa i përket planifikimit të kurrikulës në AAP, - Identifikoj procedurat që përdoren për mbledhjen e të dhënave për sistemin arsimor, komunitetin, nevojat e tregut të punës etj, - Identifikoj procedurat që përdoren për vlerësimin e të dhënave për sistemin arsimor, komunitetin, nevojat e tregut të punës etj, - Diskutoj funksionin e komiteteve dhe organeve të domosdoshme në planifikimin dhe identifikimin e përmbajtjes kurrikulare në sistemin e AAP, - Diskutoj metodat e ndryshme në dispozicion për të identifikuar përmbajtjen kurrikulare të AAP, - Themeloj rezultatet mësimore dhe kriteret e realizimit bazuar në analizën e funksioneve dhe detyrave sipas standardeve të profesionit, standardeve kombëtare industriale etj, - Diskutoj integrimin e kompetencave akademike dhe atyre profesionale në vendin e punës, - Integroj njohuritë dhe shkathtësitë bazike në fusha profesionale si: leximin, shkrimin, matematikën dhe teknologjinë në rezultatet mësimore të AAP, - Integroj shkathtësitë e komunikimit të aplikuar profesional në programet e AAP, - Organizoj dhe praktikoj përvoja të mësimit jashtë klase p.sh. gjatë vizitave në terren, përvojë punuese në grupe, studim pune, praktikë profesionale, cirakëri, dhe shërbim ndaj komunitetit, - T’ju ndihmoj nxënësve në zhvillimin e punës etike dhe shkathtësive për gatishmëri për punë, - Identifikoj faktorët që duhet të përfshihen në vlerësimin e rezultateve mësimore.
5.	<p>Vlerësimi në AAP (O), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Moduli shqyrton aspektet dhe praktikat e vlerësimit që influencojnë cilësinë e mësimdhënies dhe reformën në shkollë në përgjithësi. Në mënyrë më të theksuar, Moduli adreson aspektet e planifikimit dhe realizimit të vlerësimit sipas qasjes së bazuar në kompetenca në kuadër të reformës kurrikulare në Kosovë. Moduli adreson edhe aspektet e tjera të vlerësimit, si: natyra dhe qëllimet e vlerësimit, ndërlidhja e vlerësimit me mësimdhënien, llojet e vlerësimit. Për më shumë, Moduli trajton në hollësi edhe llojet e ndryshme të vlerësimit, si: vlerësimi i vazhdueshëm, vlerësimi për të nxënë (formativ) dhe vlerësimi i të nxënës (përmbledhës) si dy koncepte që formojnë vlerësimin që i bëjnë mësimdhënësit nxënësve, ndërsa nga aspekti praktik Moduli i ekspozon nxënësit ndaj metodave të ndryshme të vlerësimit, si: vlerësimi i bazuar në portofolio, vlerësimi i punimeve të shkruara, testet dhe cilësia e tyre etj. Përveç kësaj, Moduli adreson edhe aspektet sistematike të vlerësimit si: vlerësimet e jashtme kombëtare dhe vlerësimi i programeve.</p> <p>Qëllimi i këtij moduli është që studentët të arrijnë njohuri teorike dhe praktike të vlerësimit dhe notimit. Studentët duhet të zhvillojnë aftësitë për të vlerësuar shkathtësitë profesionale dhe për ta kuptuar vlerësimin në perspektivën më të gjerë.</p> <p>Pas kompletimit të këtij moduli studenti duhet të jetë në gjendje të:</p> <p>1. të përshkruajë matjet pedagogjike, vlerësimin dhe notimin në perspektivën historike, kombëtare dhe ndërkombëtare,</p>

	<p>2. përshkruajë dhe diskutoj për testet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe funksionin e tyre për individin, shkollën dhe shoqërinë,</p> <p>3. analizoj, identifikoj dhe vlerësoj funksionin e vlerësimit në relacion me qëllimet e shkollës dhe sistemit,</p> <p>4. vlerësoj dhe dokumentoj njohuritë dhe progresin e nxënësve bazuar në kurrikulën ekzistuese,</p> <p>5. diskutoj llojet e ndryshme të vlerësimit në aspektin e vlefshmërisë dhe besueshmërisë,</p> <p>6. identifikoj dhe përshkruajë pasojat e mundshme sociale dhe pedagogjike të vlerësimit.</p>
6.	<p>Praktika pedagogjike I (O), 12 ECTS</p> <p>Shih përshkrimin në udhëzuesin Praktika pedagogjike I dhe II (duhet të përditësohet sepse për disa mësimdhënës në shërbim, mund të llogaritet përvoja dhe trajnimet). Me rastin e realizimit të pjesës praktike në IAAP apo në ndërmarrje, studentët duhet të jenë në gjendje të:</p> <p>1. të veprojnë në përputhje me vlerat themelore të përcaktuara Legjislacionin e Arsimit, Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Kornizën Bërthamë të Kurrikulës së AAP dhe dokumentave relevante,</p> <p>2. komunikojnë në mënyrë profesionale me nxënësit, instruktorët, kujdestarët dhe stafin, prindërit, si dhe me secilin nxënës apo grupe të nxënësve duke përdorur gjuhë funksionale dhe të duhur si në të folur dhe në të shkruar,</p> <p>3. mbajë dhe vlerësojë aktivitete të ndryshme pedagogjike në të cilën janë të integruara mjetet digjitale.</p> <p>4. japin argumente për idetë me bazë të mirë teorike për plane dhe projekte të përmirësimit,</p> <p>5. analizojnë zhvillimin e tyre profesional dhe për të diskutuar nevojën për zhvillimin e vazhdueshëm.</p>
7.	<p>Programimi linear për planifikimin e AAP (O), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Qëllimi i këtij moduli është që për përdoruesit potencial të sistemit të menaxhimit të informacionit në arsimin arsimi profesional, to ofrohen njohuri për teknikën sasiore të analizës dhe shfrytëzimin e saj për të lehtësuar për të mundësuar planifikim më efektiv të programeve të arsimit profesional. Përdorimi i “Programimit linear (PL)” si teknikë e menaxhimit që përdoret për të zgjidhur problemet komplekse, që kanë të bëjnë me alokimin e burimeve dhe optimizmin e tyre në industri, biznese dhe institucione arsimore dhe qeveritare, paraqet një potencial të madh edhe për planifikimin në sistemin e AAP dhe lidhjen e PL me sistemin e menaxhimit të informatave në arsim. Në këtë modul studentët do të njihen edhe për përparësitë dhe dobësitë e përdorimit të PL për planifikim në arsim. Modeli i planifikimit fillestar në sistemin e AAP paraqet aspektet dinamike dhe variacionet në model duke ofruar një model përfaqësues.</p>
8.	<p>Strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies (O), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Moduli përmban përmbajtje për strategjitë e reja në mësimdhënien bashkëkohore. Në modul trajtohen aspekte të mësimdhënies efektive, përmbajtje aktuale për të nxënësit si proces kognitiv dhe parakushtet që e mundësojnë të nxënësit si proces intelektual. Po ashtu në modul trajtohen edhe teknikat dhe praktikat e reja të domosdoshme për motivimin e subjekteve për të nxënësit të suksesshëm. Në modul do të trajtohen edhe strategjitë dhe qasjet bashkëkohore për punë me nxënës si dhe filozofitë e ndryshme me nxënësin në qendër, si: të nxënësit në bashkëpunim, të nxënësit ndërveprues, zgjidhja e problemeve dhe të nxënësit e bazuar në projekte. Thëks i veçantë i kushtohet mësimi të</p>

	bazuar në kompetenca, sidomos në fushën e AAP-së
9.	<p>Politikat arsimore dhe legjislacioni (Z), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Moduli ofron mundësi për studentët të njihen me ciklin e zhvillimit të politikave arsimore, si dhe me politikat aktuale në fuqi, si: dokumente kurrikulare, strategjitë dhe politikat e ndryshme të standardeve të mësimdhënies, licencimi i mësimdhënësve dhe politika të tjera të ngjashme në sistemin arsimor në Kosovë. Moduli, gjithashtu, ofron mundësi për studentët të njihen me dokumentet kryesore legjislative në sistemin e arsimit në Kosovë si ligjet e arsimit dhe udhëzimet e ndryshme administrative që rregullojnë aspekte të ndryshme të funksionimit të sistemit arsimor në Kosovë. Theks i veçantë i kushtohet legjislacionit dhe politikave në fushën e AAP-së.</p>
10.	<p>Kulturë e komunikimit dhe shkathtësitë komunikuese (Z), 2+2, 6 ECTS</p> <p>Moduli ofrohet për të promovuar kulturën komunikuese në arsim dhe për të avancuar shkathtësitë komunikuese. Në modul do të trajtohet kuptimi i nocionit kulturë komunikimi vështruar nga aspekti teorik dhe praktik. Në modul trajtohen aspektet më të përgjithshme të komunikimit, të modaliteteve, teknikave dhe ecurive bashkëkohore për komunikim në veprimtarinë arsimore me qëllim të avancimit të shkathtësive themelore intelektuale në mësim, si të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit aktiv me qëllim të zbatimit të suksesshëm të tyre në praktikë. Në modul ofrohen përmbajtje për modalitetet dhe kërkesat aktuale për komunikim ndërveprues në mësim, duke iu referuar komunikimit autoaksional, koaksional dhe format e ndryshme të komunikimit në grup për qëllime mësimore. Veçmas do të trajtohet aktualiteti dhe zbatimi modalitete të fjalës së folur dhe të fjalës së shkruar, si dhe të modaliteteve aktuale të komunikimit në arsim</p>
11.	<p>Praktika pedagogjike II (O), 10 ECTS</p> <p>Shih përshkrimin në udhëzuesin Praktika pedagogjike I dhe II (duhet të përditësohet sepse për disa mësimdhënës në shërbim, mund të llogaritet përvoja dhe trajnimet)</p>
12.	<p>Edukimi për karrierë dhe mësimi gjatë gjithë jetës (O), 2+2, 5 ECTS</p> <p>Në këtë modul mundësohet përvetësimi e koncepteve bazë dhe i disa njohurive më të avancuara në fushën e edukimit për karrierë dhe planifikim të zhvillimit profesional. Në modul trajtohen faktorët relevantë për edukimin për karrierë dhe analizohen hapat për identifikimin, planifikimin, organizimin dhe realizimin e karrierës individuale të individit. Në modul ofrohen burime të ndryshme të informacioneve për mundësitë dhe format e ndryshme të ngritjes arsimore para shërbimit dhe në shërbim, si dhe hulumtohen mundësitë për realizimin e potencialeve individuale për arsimim në sferat e mundshme. Po ashtu, në modul do të analizohen konceptet e ndryshme që burojnë nga Korniza Kombëtare e Kualifikimeve dhe konteksti i shkollave profesionale. Moduli trajton edhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm, si familja, rrethi shoqëror dhe ndikues të tjerë të mundshëm, që ndikojnë dhe ndihmojnë në orientimin e individit në përzgjedhjen e drejtimeve të veçanta me perspektivë në karrierën e të rinjve. Moduli ekspozon studentët ndaj konceptit të analizës së tregut të punës dhe, me këtë rast, identifikohen epërsitë dhe rreziqet gjatë orientimit në drejtime të ndryshme. Në këtë modul do të adresohet arsimi gjatë gjithë jetës si filozofi e të nxënimit në shoqërinë bashkëkohore, duke trajtuar historikun e paraqitjes së idesë për arsimin gjatë gjithë jetës, përcaktuesit që e intensifikuan nevojën për masivizimin e idesë për arsimin gjatë gjithë jetës si dhe ideologët që i paraprijnë idesë për arsimin gjatë gjithë jetës. Në vijim do të trajtohen konceptet bazë si dhe modalitetet e arsimit gjatë gjithë jetës në teori dhe praktikë.</p> <p>Me përfundimin e këtij moduli studenti duhet të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikoj interesin për karrierën, shkathtësitë për punë, vlerat e punës dhe

	<p>qëllimet jetësore,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aplikoj njohuritë për interesa personale, zotësitë dhe vlerat për të planifikuar dhe vendimmarrje mbi fushën e studimit dhe opsionet në karrierë, - Kuptuar zbrazëtitë ndërmjet realitetit ekzistues dhe aspiratave të së ardhmes dhe të ndërmarrë veprime për të adresuar zbrazëtitë dhe nevojat profesionale, - Zhvilloj objektivat për shtegun e aspiruar të zhvillimit profesional dhe opsionet e synuara të karrierës, - Kuptoj procesin e planifikimit të karrierës dhe të zbatoj shkathtësitë për vendim marrje për planifikim të shkollimit dhe të karrierës, - Artikuloj planin afatshkurtër dhe afatgjatë të arsimit dhe karrierës, - Vlerësoj ndikimin dhe pasojat e secilit opsion të vendimit për vetveten dhe të tjerët, - Pranoj nevojën për përmirësim të vazhdueshëm dhe mësim gjatë gjithë jetës, në përpjekjet e tij për të arritur objektivat në aspektin profesional, akademik dhe të karrierës, - Aplikoj fleksibilitet dhe optimalizoj shfrytëzimin e resurseve në dispozicion për ta avancuar vetveten sa më afër me qëllimet profesionale, akademike dhe karrierës jetësore, - Ketë besim në aftësitë e tij për të arritur qëllimet jetësore.
13.	<p>Menaxhimi në IAAP (O), 2+2, 5 ECTS</p> <p>Në këtë modul studentët do të mësojnë për këto fusha; bazat e menaxhimit, bazat e menaxhimit të cilësisë në IAAP, instrumentet dhe metodat në menaxhimin e cilësisë, menaxhimi i ndryshimeve dhe komunikimi i tyre, menaxhimi i procesit mësimor dhe projekteve, etj.</p> <p>Qëllimi i këtij moduli është që t'ju mundësohet studentëve të zhvillojnë njohuritë bazike për udhëheqje pedagogjike dhe lidërsip nga perspektiva e AAP.</p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. njohin bazat dhe funksionet e menaxhmentit, 2. dijnë për menaxhimin e cilësisë dhe ciklet e menaxhimit të cilësisë, 3. të shpjegojnë bazat e teorive të lidërsipit, me fokus në mësimdhënien e lëndëve të ndryshme, 4. të shpjegojnë dhe diskutojnë teorinë e lidërsipit, komunikimit, proceset e punës në grup, mësimdhënien dhe mësimnxënien, mardhëniet shoqërore dhe menaxhimin e konflikteve në kontekstin shkollor, 5. të zbatojnë lidërsipin nga perspektiva e diversitetit, 6. të shpjegojnë lidërsipin në lidhje me teorinë e ndryshme për module përkatëse, për sa i përket procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, 7. të diskutojnë se si lidërsipi i mësimdhënies të AAP mund të kontribuoj në qasjen ndërmarrëse të nxënësve në IAAP.
14.	<p>Edukimi inkluziv (O), 2+2, 5 ECTS</p> <p>Moduli ofron njohuri të avancuara për vështirësitë karakteristike në të nxënë dhe në specifikat e edukimit inkluziv. Në këtë lëndë trajtohen tema që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të vështirësive, llojet dhe natyrën e manifestimeve të tyre si dhe sqarimin e filozofisë për inkluzionin, i cili mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut/fëmijës dhe të barabarësisë së individit në shoqëri. Në modul trajtohen format e inkluzionit në vende evropiane, mundësitë e krijimit të një shkolle dhe shoqërie inkluzive, etj. Në modul ofrohen përmbajtje për zhvillimin e shkathtësive</p>

	për planifikimin dhe zbatimin e suksesshëm të strategjive, metodave e teknikave bashkëkohore të edukimit inkluziv, të cilat relativizojnë vështirësitë në të nxënë dhe gradualisht shpjen në drejtim të krijimit të një klase dhe shkolle inkluzive.
15.	<p>Edukimi i të rriturve (Z), 2+2, 5 ECTS</p> <p>Moduli ofrohet për të promovuar filozofinë e arsimit dhe të nxënit në kontekst të ndryshimit të vazhdueshëm dhe ngritjes dhe aftësimit të subjekteve të rritur. Në modul trajtohen aspekti kronologjik- kohor i zhvillimit të shkencës dhe të mendimit andragogjik, kuptimi i “njeriut të rritur” dhe ndryshimet në rrafshin psiko-fiziologjik të njeriut. Në modul do të përpunohen bashkërisht me studentë përmbajtje të avancuara për teoritë e ndryshme të të nxënit të rriturve, duke filluar nga teoria transformativë, teoria e resurseve sociale e humane etj. Moduli do të ofrojë informata edhe për aftësimin e vazhdueshëm, për kualifikimin, rikualifikimin, apo për kualifikimin për profesion të ri në shoqërinë globale si dhe për identifikimin e qasjeve dhe strategjive të planifikimit të mësimdhënies për të rritur.</p>
16.	<p>Teknologjitë e reja dhe mësimi në distancë (Z), 2+2, 5 ECTS</p> <p>Moduli ofrohet për të promovuar procesin e njohjes dhe zbatimit të teknologjisë në veprimtarinë arsimore në praktikë. Në modul trajtohen aspektet më të përgjithshme të teknologjive të reja, duke filluar nga zbulimet e reja softuerike, platformave për të nxënë në distancë si dhe modaliteteve të tjera për të nxënë dhe për të komunikuar në largësi. Moduli ofron modele aktuale të zbatimit të teknologjisë arsimore dhe të komunikimit në sisteme të hapura, gjysmë të hapura dhe në sistemet e mbyllura të zhvillimit profesional formal dhe joformal. Në modul do të përpunohen përmbajtje të avancuara për dimensionet polivalente të teknologjive të reja multimediale, të arriturat dhe perspektiva e tyre në kushtet e zhvillimit teknik, teknologjik e shkencor. Moduli do të ofrojë informata edhe për aftësimin e vijuesve për identifikimin dhe shfrytëzimin e resurseve që ofron teknologjia arsimore dhe e komunikimit në aspektin e hapjes së perspektivave të reja për industrinë 4.0.</p>
17.	<p>Zhvillimi profesional (Z), 2+2, 5 ECTS</p> <p>Në këtë modul trajtohet zhvillimi profesional i mësimdhënësve në përgjithësi dhe në fushën e AAP-së në veçanti. Moduli adreson modele të ndryshme të zhvillimit profesional, si: modeli me bazë në shkollë, modeli i trajnimit të trajnerëve, si dhe fokusohet në cilësitë e zhvillimit profesional efektiv. Më tej, Moduli adreson edhe aspektet e mentorimit të mësimdhënësve, si dhe reflektimit (mësimdhënësi reflektiv) si koncepte themelore në zhvillimin profesional të mësimdhënësve e në veçanti në fushën e AAP-së, duke u lidhur me standardet dhe kompetencat e kërkuara në fushën e AAP-së.</p>
18.	<p>Teza e masterit, 30 ECTS</p> <p>Tema e masterit përmban 30 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Kualifikimit për mësimdhënës të AAP, niveli 7 i KKK. Rregullorja e studimeve Master të ofruesve të këtij kualifikimi rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit, duke u bazuar në kërkesat e Standardit të profesionit.</p> <p>Tezën e masterit studenti duhet ta përfundoj si projekt final në kompani. Nëse nuk ka vend në kompani atëherë punimi i masterit mund të punohet si projekt përfundimtar nga studenti ose ekipi i studentëve (1 deri 4 vetë në ekip), në laboratorët e universitetit ose të IAAP. Përparësi është që punimi i temës së masterit të bëhet në kompani, sepse i jepet mundësia të palëve të kenë raporte bashkëpunimi në të ardhmen. Kreditë do të kalkuloohen si për pjesën teorike dhe pune praktike (puna laboratorike).</p>